



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më  
31.1.2025, e cila filloi në orën 10:30.

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Berna Saraçi (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Berat Lahu (LVV) Petrit Reçica (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Sami Salihu (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Xhavit Ahmeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Arianit Beqiri (LVV), Endrit Zabërgja (NISMA), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama - kryetar, Alban Zogaj - nënkryetar, Jehona Lushaku-Sadriu - nënkryetare, Valbona Ajeti - drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi - drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të qytetarëve dhe të medieeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina - kryesues i Kuvendit.  
Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

---

### Faqe 1 nga 8

**Alban Zogaj:** - nënkryetar propozoi që në rend të ditës të hyjnë edhe këto pika:

1. Propozim - vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit 2" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr. 465-25/85 të datës 8 korrik 1985;
2. Propozim - vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin Hyzri Talla;
3. Propozim - vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës.

**Jehona Lushaku,** nënkryetare: - propozoi që në rend të ditës të hyjë pika: Propozim - vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve.

**Gëzim Sveçla:** - propozoi që pika e nëntë e rendit të ditës që ka të bëjë me Propozim-vendimin për caktimin e lokacionit, për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit të xhamisë në fshatin Shkabaj të Komunës së Prishtinës, të dalë si pika e dytë e rendit të ditës pas miratimit të ekstraktit të procesverbalit.

**Feim Osmani:** - propozoi që në rend të ditës të hyjë pika: Diskutim për linjat e transportit Prishtinë - Tenezhdoll dhe Prishtinë - Sharban.

**Gëzim Mehmeti:** - kërkoi të dijë arsyen e ndërrimit të pikave të rendit të ditës dhe lidhur me këtë ceku se kisha pas dëshirë me ditë edhe qëllimin në realitet dhe kisha pas shumë dëshirë që kjo mbledhje të ketë kuorum, pasi që e kam një brengë që kjo ka me zgjat më së paku gjysmë ore dhe ka me përfunduar.

**Jeta Rafuna:** - propozoi që pikat: Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit - xhamisë në fshatin Orloviq, të Komunës së Prishtinës; Propozim - vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit 2" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr. 465-25/85 të datës 8 korrik 1985, të jenë pas miratimit të ekstraktit të procesverbalit.

**Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna:**

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Zogaj që: Propozim - vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit 2" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985, hyn në rend të ditës për diskutim.**

**Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, u miratua propozimi i z. Zogaj që: Propozim - vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin Hyzri Talla, hyn në rend të ditës për diskutim.**

**Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 15 kundër, u miratua propozimi i z. Zogaj që: Propozim - vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës, hyn në rend të ditës për diskutim.**

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për u miratua propozimi i znj. Lushaku që: Propozim - vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve, hyn në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, u miratua propozimi i z. Sveçla që: Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit - xhamisë në fshatin Orllloviq, të Komunës së Prishtinës, të jetë pika e dytë në rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Osmani: Diskutim për linjat e transportit Prishtinë - Tenezhdoll dhe Prishtinë - Sharban, të hyjë në rend të ditës për diskutim.

Me ndryshime dhe plotësime, kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, u miratua ky

#### Rend dite:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancave të jashtëzakonshme dhe të seancës së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit - xhamisë në fshatin Orllloviq, të Komunës së Prishtinës;
3. Propozim - vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit 2" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr. 465-25/85 të datës 8 korrik 1985;
4. Propozim - vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin Hyzri Talla;
5. Diskutim për linjat e transportit Prishtinë - Tenezhdoll dhe Prishtinë - Sharban;
6. Propozim - vendimi për subvencionimin e Nina Leutrim Dragushës për shpenzimet e trajtimit shëndetësor jashtë vendit;
7. Propozim - vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025 - 2026;
8. Propozim - vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
9. Propozim - vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet. nr. - 01 020/05 - 69249/23 dt. 3.4.2023;

10. Propozim - vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
11. Propozim - vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve;
12. Propozim - vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues "Çagllavicë";
13. Propozim - vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona Ekonomike";
14. Propozim - vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për Artin dhe Kulturën 2026-2031;
15. Propozim - vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;
16. Pyetje dhe përgjigje;
17. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancave të jashtëzakonshme dhe të seancës së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit.**

**Gëzim Mehmeti:** - kërkoi të dijë nga Shërbimi i administratës se a ruhen në tërësi të gjitha procesverbalet, për arsye se shpesh kuptimi i fjalës në realitet që ka të bëjë me mua, nuk është ajo që kam dashtë me thënë. E di që në ekstrakte vetëm një pjesë merret, por çka mua më intereson se në aspektin digjital a ruhen të gjitha seancat e Kuvendit.

**Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të seancave të jashtëzakonshme dhe të seancës së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit.**

#### **Pika e dytë**

**Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit - xhamisë në fshatin Orloviq, të Komunës së Prishtinës.**

Lidhur me këtë propozim-vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiki - drejtor.

**Nora Kelmendi:** - dha vërejtje rreth dokumentacionit të kësaj pike e cila tha se kjo pikë e rendit të ditës nuk na ka ardhur me të gjithë dokumentacionin, në ç'rast tha se mungon dokumentacioni përcjellës nga AKP-ja, pra marrëveshjen e Komunës me AKP-në, apo dokumentet të cilat janë dërguar ose inicimin e procedurës me AKP-në. Po ashtu dy parcela janë të KBI "Kosova eksport", ndërsa një parcelë me nr. 44/2 në Orloviq është pronë komunale, si dhe pjesa e parcelës nr. 44/25 nuk është pjesë e vendimit. Tutje tha se ne nuk jemi kundër këtij vendimi, por jemi që lënda të jetë sa më e kompletuar.

**Jeta Rafuna:** - tha se ne si GP i LDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim për miratim.

**Gëzim Mehmeti:** - tha se e përkrahim këtë iniciativë, por në këtë rast shihet që pronësia nuk është pronë e Komunës së Prishtinës, në realitet është pronë e cila duhet një marrëveshje mes Komunës së Prishtinës dhe agjencionit i cili është kompetent në këtë rast. E vetmja çështje që ne mund ta bëjmë është që të përshpejtohet marrëveshja mes Komunës së Prishtinës dhe AKP-së, që të definohen çështjet, pastaj në Kuvend të fillohet me procedurat dhe ekzekutivi këtë veprim të mirë ta realizojë.

**Gëzim Sveçla:** - tha se ne sot po e bëjmë një veprim që kemi mundur shumë me herët me e bë, kështu që sot vetëm e përcaktojmë lokacionin që në ato parcela do të ndërtohet xhamia dhe institucioni parashkollor, për shkak se nuk mundemi me nda parcela, të cilat janë pronësi e dikujt tjetër. Ne s'jemi pronarë të atyre parcelave, por kjo na jep të drejtën që me i përshpejtuar negociatat me AKP-në për ndarjen e atyre parcelave.

**Ermal Osmani:** - ju shprehu mirënjohje të gjithë atyreve për angazhimin që e kanë bë duke filluar prej imamit Bahri Sejdiut, kryetarit të bashkësisë lokale Avni Osmanit dhe të gjithë banorëve të atij lokaliteti.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Arbër Sadiki - drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit - xhamisë në fshatin Orllloviq, të Komunës së Prishtinës.

**Pika e tretë**

**Propozim-vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit II" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr.465-25/85 të datës 8 korrik 1985.**

Për Propozim-vendimin për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit II" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijimin nr. 07 nr.465-25/85 të datës 8 korrik 1985, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Alban Zogaj - nënkryetar.

**Gëzim Sveçla:** - tha se Lëvizja Vetëvendosje e përkrah formimin e këtij komisioni, por ne i kemi dy propozime që mendojmë se kishin me ndihmuar punën e këtij komisioni dhe kërkoi që të njëjtat të bëhen pjesë e këtij vendimi. Pjesë e këtij komisioni duhet të jetë Drejtorja e e Kadastrit dhe jo Drejtorja e Planifikimit. Po ashtu propozimi i dytë është që këtij komisioni t'i jepet një afat kohor që mos lihet në pafundësi, të ketë afatin 6 - mujor brenda të cilit duhet të vijë para Kuvendit me të gjeturat e veta.

**Jeta Rafuna:** - tha se, ne si GP i LDK-së e përkrahim formimin e komisionit dhe po ashtu pajtohemi për afatin kohor, mirëpo të jetë edhe më i shkurtër 3 ose 4 muaj.

**Sami Boroci:** - tha se edhe ne e përkrahim formimin e këtij komisioni dhe që personalisht kam pas informata në lidhje me problemin që këta banorë e kanë dhe shumë mirë që sot ka ardh në Kuvend dhe po tentojmë me ju ofruar një zgjidhje. Mandej tha se këkoj një përgjigje prej ekzekutivi, arsyen pse AKR-ja është jashtë këtij plani punues.

**Gëzim Mehmeti:** - tha se pajtohem që ky propozim sot të miratohet dhe pyetja ime është që është shumë me rëndësi që nuk po shohim grafiksht së çfarë do të ndodhë në aspektin profesional ku janë të përfshira të gjitha parcelat. Po ashtu propozoi që pjesë e këtij grupi punues të jetë edhe AKR-ja.

**Gëzim Sveçla:** - në emër të GP të LVV, për anëtar të komisionit propozoi Ermal Osmanin.

**Jeta Rafuna:** - në emër të GP të LDK-së, për anëtar të komisionit propozoi Driton Rukiqin.

**Gëzim Mehmeti:** - për GP të AAK-së për anëtar të komisionit propozoi Endrit Gashin.

**Sami Boroci:** - në emër të GP të AKR-së, për anëtar të komisionit propozoi Gëzim Mehmetin.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes "Kodra e Diellit II" për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr.465-25/85 të datës 8 korrik 1985.

**Pika e katërt**

**Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin Hyzri Talla.**

**Nora Kelmendi:** - tha se për hir të sakrificës së dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi, Ilir Durmishi ne do ta shqyrtojmë propozimin e këtij vendimi, mirëpo ky dokumentacion për këtë propozim-vendim është i pakompletuar. Këtij propozim-vendimi i është bashkëngjitur certifikata e pronësisë pa vulë dhe pa nënshkrim, kështu që kërkohet që të na sillen dokumentet e kompletuara.

**Gëzim Sveçla:** - kërkoi nga ekzekutivi që të përgatitet dokumentacioni i plotë për këtë propozim-vendim dhe si grup parlamentar do ta përkrahim për miratim.

**Feim Osmani:** - tha se ne nuk jemi kundër këtij propozim-vendimi, por jemi kundër materialit të pakompletuar që na është sjellë, kështu që do të ishte mirë që kur të votohet ky vendim të mos na kthehet nga ministria si i paligjshëm.

**Gëzim Mehmeti:** - tha se është shumë me rëndësi që dokumentacioni të jetë në rregull, për arsye që të mos humbim kohë, sepse këtij mandati i ka mbetur edhe shumë pak kohë, diku 6, 7 muj ku mund të merrë vendime, pastaj fillon çështja e fushatës parazgjedhore, zgjedhore dhe në qeshor diku me një vendim sipas Kushtetutës së Presidencës, atëherë ne nuk kemi të drejtë që të marrim kompetenca, të marrim vendime që janë shumë bazike për qytetarët.

*Duke pasur për bazë vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, kryesuesi kërkoi nga ekzekutivi që kjo pikë të shtyhet derisa të sillen dokumentacioni komplet, kështu që pas pauzës me të filluar mbledhja do të vazhdojmë me diskutimin e saj.*

## **Pika e pestë**

### **Diskutim për linjat e transportit Prishtinë-Tenezhdoll dhe Prishtinë-Sharban**

**Feim Osmani:** - tha se ne kemi kërkuar me ngulm që këto linja të lëshohen në qarkullim dhe të futen drejtpërdrejt brenda menaxhmentit të trafikut urban, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Linjat e fundit të kontraktuara nga Komuna e Prishtinës me operatorë privat me të cilët komuna ka synuar të arrijë shërbimet e transportit publik për banorët e fshatrave që shtrihen përgjatë magjistrales Prishtinë-Besianë siç janë: Truda, Lebana, Prugoci, Barileva, Besia, Rimanishta, Vranidolli, Tenezhdolli, Sharbani po del të jenë linja që kanë paraqitur shumë e shumë probleme se sa që kanë krijuar lehtësira për banorët. Shkaqet për këtë tashmë janë të njohura, së pari këto linja janë lëshuar në qarkullim pa planifikim paraprak, pa plan të mobilitetit, pa marrëveshje me institucionin që është përgjegjës për rrugët magjistrale e me shumë mangësi tjera. Të gjithë banorët e këtyre fshatrave të Komunës së Prishtinës i keni lënë në mëshirën e operatorëve të linjave ndërurbane, me orare sipas dëshirave të tyre e çmime të frikshme, pra i keni mashtruar banorët me një shërbim i cili në fakt nuk po ofrohet fare.

Për vërejtjet e paraqitura nga z. Osmani, sqarime shtesë dha Përparim Rama - kryetar.

## **Pika e gjashtë**

### **Propozim - vendimi për subvencionimin e Nina Leutrim Dragushës, për shpenzimet e trajtimit shëndetësor jashtë vendit.**

**Kryesuesi:** - tha se këtë propozim-vendim e kam propozuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, bazuar në kërkesën e një qytetari ku ka të bëjë me mbështetjen financiare në shumën prej 10.000 euro për Nina Dragushën, për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor.

**Faton Zeka:** - tha se jemi të vetëdijshtë për gjendjen e familjes Dragusha për ndihmën. Si prind bashkëndjej dhe lutem që vajza e tyre të shërohet plotësisht, ndërkaq normalisht që jemi në mbështetje të propozimit.

**Berat Lahu:** - tha se ne si asamblistë nuk jemi të njoftuar për këtë rast, kështu që neve na duhet me ditë se ku po trajtohet, qysh po trajtohet, pra me e pas një arsytim. Unë e votoj këtë propozim-vendim, por tash e tutje për vendimet e tilla duhet ta kemi dokumentacionin e kompletuar.

**Kryesuesi:** - tha se kërkesa e qytetarit për këtë rast ju është dërguar edhe shefave të grupeve parlamentare dhe besoj se lënda është e kompletuar dhe e kam propozur. Këtu nuk ka asnjë mashtrim dhe e gjithë Prishtina e di se brenda 24 orëve janë mbledhur 144 mijë euro për trajtim në Turqi, mirëpo nuk ka përfunduar e tëra dhe ka bërë kërkesë për ndihmë nëse ka mundësi dhe unë e mbështes këtë kërkesë.

**Radie Hoxha:** - kërkoi të dijë për diagnozën e fëmijës, sepse kam vërejtur që në Kosovën e pasluftës edhe ata që kanë mjekim në Kosovë për disa gjëra të thjeshta ata kërkojnë mjete për shërim të sëmundjeve.

Për çështjen e ngritur nga znj. Hoxha, kryesuesi tha se diagnozën e fëmijës e keni në dokumentacion të cilin e keni në e-mail.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e Nina Leutrim Dragushës për shpenzimet e trajtimit shëndetësor jashtë vendit.

Pas një pauze prej një orë, me të filluar vazhdimi i mbledhjes, në mungesë të kuorumit kryesuesi e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:30.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina



Faqe8nga8